



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më 19.6.2023, me fillim në ora 10:25. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **zt. Defrim Kafexhiu**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'ju përshëndes të gjithëve, Nënkryetarin **Fatmir Iska**, drejtorët e drejtorive. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, përfaqësues të KFOR-it, zyrtarë komunalë, të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit për pjesëmarrjen. E hapim mbledhjen e pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023.

Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB)- 2024-2026;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-00386-1, ZK-Pastaselë;
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-00364-0, ZK-Polluzhë;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-01031-0, ZK-Polluzhë;
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-00331-0, ZK-Mrasor;
8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-01987-0, ZK-Opterushë;
9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-00050-0, ZK-Opterushë;
10. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-01015-12, ZK-Xërxë;
11. Shqyrtimi i raportit të komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane;
12. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shërbimet Publike;
13. Të ndryshme.

Shtesë:

1. Shfuqizimi i vendimit Nr. 63/23 për vënien në mbrojtje të "Kanionit të Drinit të Bardhë";
2. Raporti 6 mujor i punës së kryetarit;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, P- 01313-3, ZK-Rahovec.

Kryesuesi – Ky është rendi i ditës për sot. Nëse dikush prej anëtarëve të KPF-së ka diçka për të thënë, mund ta marrë fjalën! Nëse jo, atëherë kemi edhe tri pika shtesë (pikat më lartë).

Rumir Zhuniqi – Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë, kolegë. Para se ta fusim në rend dite, cila është arsyeja e shfuqizimit të vendimit për Kanion?

Kryesuesi – Atëherë, arsyetimi për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit është i bazuar në tri mospërputhje me ligjin. Ky vendim nuk është në harmoni me ligjin 03/L-233 për mbrojtjen e natyrës si dhe me dy ligje tjera. Nëse kuvendi jemi të obliguar ta shfuqizojmë në afat brenda afatit 30 ditësh. Atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash, përfshihet edhe kjo pikë në rend dite për këtë mbledhje. Si pikë tjetër shtesë është edhe Raporti 6 Mujor i punës së kryetarit. A ka dikush diçka për të thënë?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim edhe këtë pikë, e cila me shumicë votash përfshihet edhe kjo pikë në rend dite. Një pikë shtesë tjetër është edhe propozim-vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, P-01313-3, ZK – Rahovec. Kush është “për” përfshirje në rend dite? Me shumicë votash edhe kjo pikë përfshihet në rend dite për sot. Kjo mbledhje i ka gjithsej 16 pika. Po e vendosim si të tillë miratimin e rendit të ditës për mbledhjen e sotme, kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – A ka dikush prej anëtarëve ndonjë koment, apo diçka për të thënë rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB)- 2024-2026;

Afrim Limani – Faleminderit kryesues! Përshëndetje nënkryetar, anëtarë të KPF-së, përfaqësues të LMT-së. KAB-i komunal konsiderohet një dokument voluminoz dhe i përgatitun mjaftë mirë me të gjitha analizat e buxhetit 2024, 2025 dhe 2026. Këtu janë të përcaktuara synimet, zotime dhe prioritetet tona. E veçanta e këtij dokumenti është se për herë të parë e kemi përgatitë buxhetimin gjinorë dhe në kategorinë e subvencioneve do të ndajmë buxhet për gjininë femrore. Buxheti për vitin 2024 është 20 milion e 34 mijë €, mallra dhe shërbime 6 milion, paga është 10 milion e 300 mijë, mallra dhe shërbime 2.466.000, komunalitë 370.000, në subvencione 890.000€.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A ka dikush diçka për të thënë rreth KAB-it?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e dytë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023;

Afrim Limani – Siç jeni në dijeni edhe ju, kjo pikë e rendit të ditës vjen për herë të tretë në KPF dhe për herë të tretë në Kuvend. Arsyet i dini, qeveria ka marrë vendim që shuma e mjeteve të bllokohet, pastaj vendimi tjetër thotë që këto mjete mund të zhblokohen dhe ne detyrohemi ta vendosim në mbledhje të rregullt të kuvendit. Ju rikujtoj se shuma e bartur është 490.416€, pjesa e mjeteve nga fondi burimor 22, është 58.267€.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A ka dikush diçka për të thënë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet pika e tretë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e katërt, vetëm që, prej pikës 4 deri te pika e 10-të janë të propozuara nga drejtoria e Gjeodezisë, e ftoj drejtorin që t’i prezantojë secilën pikë dhe pastaj i votojmë veç e veç.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-00386-1, ZK-Pastaselë;

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-01031-0, ZK-Polluzhë;

7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-00331-0, ZK- Mrasor;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë, të nderuar anëtarë të KPF-së. Unë po i prezantoj shpejt, më pas i votojmë një nga një. Janë tri prona që menaxhohen nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, dallojnë me sipërfaqe dhe ne po kërkojmë nga ju që t’i shpallim me interes të përgjithshëm me qëllim të këmbimit që në të ardhme të bëhen terrene sportive. Bëhet fjalë për zonën kadastrale në Pastasel, Polluzhë dhe Mrasor (pika 4, 6, 7)

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-00364-0, ZK- Polluzhë;

Afrim Oruqi – Bëhet fjalë për shpallje me interes të përgjithshëm pjesën e sipërfaqes së përgjithshme në hapësir prej 2 ari e 10m. Në terren është rrugë faktike e kalueshme dhe po kërkojmë nga ju që ta shpallim me interes të përgjithshëm, prona është në emër të Ibrahim (Zeqë) Hoti – Polluzhë.

8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-01987-0, ZK-Opterushë;

9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-00050-0, ZK-Opterushë;

Afrim Oruqi – Janë dy parcela në zonën kadastrale në Opterushë, të dyjat janë në kulj ku veq janë duke u zhvilluar punimet për Zonën Ekonomike. Kërkojmë nga ju që t'i shpallim me interes të përgjithshëm sipërfaqen prej 4 ari prej pjesë së përgjithshme me nr. P-01987-0, në seanca tjera të marrim pëlqim për këmbim. P-00050-0, është sipërfaqe që menaxhohet nga pasuria shtetërore e Kosovës që menaxhohet nga ekonomia e pyjeve dhe po kërkojmë që ta shpallim interes të përgjithshëm 1 ha e 20 ari. Qëllimi është qasja në parcelën që po ndërtohet Zona Ekonomike.

10-Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-01015-12, ZK- Xërxë;

Afrim Oruqi – Sipërfaqja e përgjithshme e kësaj parcele është 60 ari dhe ne kërkojmë nga ju që të shpallim interes të përgjithshëm 1 ari e 34m. Kjo sipërfaqe është në pronësi të Sylejman Hamdi Kryeziu. Si qëllim kemi këmbimin dhe e njëjta parcelë kufizohet me pronën komunale.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! Atëherë veç e veç po i shqyrtojmë pikat. Duke filluar prej pikës së 4-të, parcela në Pastasel. E kam një pyetje drejtor: Meqenëse kjo parcelë është prej Agjencionit të Pyjeve, për interes të komunës së Rahovecit për ndërtimin e terreneve sportive, a është mundësia që këto parcela të jenë me më shumë ari, me hapësirë më të madhe dhe besoj që do të ishte arsye e mirë që në mungesë të pronave komunale, këto prona t'i përvetësojmë prej agjencionit.

Afrim Oruqi – Në koordinim të plotë me drejtorin e kulturës, kemi projekte për këto tri zona (Pastasel, Mrasor dhe Polluzhë), sipas DKRS-së për ta implementuar një projekt të tillë nuk na nevojiten më shumë se 3 ari, kurse ne i kemi kërkuar 5 ari.

Afrim Dina – Faleminderit kryesues! Terrenet sportive që janë me dimensione 30 me 20m, shqyrtohen në ministri atje dhe duke u bazuar në kërkesat psh: 10 ari ose 15, bie në kundërshtim me paramasë dhe nuk e aprovojnë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! Atëherë nëse edhe dikush nuk ka diçka për të thënë, po e vendosim në votim pikën e katërt. Kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e katërt e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e pestë, P-00364-0, ZK-Polluzhë. A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së diçka për të thënë?...Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e pestë e rendit të ditës. Vazhdojmë me të gjashtën, P-01031-0, ZK-Polluzhë. A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së diçka për të thënë?...Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e gjashtë. Vazhdojmë me pikën e shtatë, P-003310, ZK-Mrasor. A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së diçka për të thënë?...Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet pika e shtatë. Vazhdojmë me pikën e tetë, P- 01987-0, ZK-Opterushë. A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së diçka për të thënë?...Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e tetë. Vazhdojmë me pikën e nëntë, P- 00050-0, ZK-Opterushë. A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së diçka për të thënë?...Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet pika e nëntë. Vazhdojmë me pikën e dhjetë, P-01015-12, ZK- Xërxë. A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së diçka për të thënë?...Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet pika edhe pika e dhjetë.

11. Shqyrtimi i raportit të komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane;

Nora Boshnjaku – Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë, anëtarë të KPF-së, përfaqësues të OSBE-së. Para vetes e kemi një raport me procesverbal për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve urbane. Në raport i kemi të gjitha informacionet bazike, komisioni e ka kryer punën konform rregullores për organizimin dhe

bashkëpunimin e komunës me fshatra dhe lagje urbane. Komisioni ka qenë i përbërë prej 7 anëtarëve: Melinda Oruqi – Iska, Faton Ramadani, Afrim Berisha, Leonard Morina, Vjollca Gurgule, përfaqësuesi i fshatrave dhe unë, Nora Boshnjaku. Janë zgjedhur 29 kryetarë të këshillave lokal dhe na kanë mbetur edhe disa lokacione, për arsye të mos shprehjes së interesimit.

Kryesuesi – Faleminderit drejtoreshë! A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së ndonjë pyetje?... Nëse jo, atëherë kalojmë te pika e dymbëdhjetë.

12. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shërbimet Publike;

Kryesuesi – Në mungesë të drejtorit, diskutimi do të bëhet në kuvend, meqenëse është vetëm informata.

13. Shfuqizimi i vendimit Nr. 63/23 për vënien në mbrojtje të “Kanionit të Drinit të Bardhë”;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues! Bashkë me ministrinë e Mjedisit e kemi bërë vendimin për Kanionin Drini i Bardhë, e kemi pasë edhe një takim me ta. Për shkak të personelit të vogël, ata na kanë kërkuar falje për këtë gjë, u ka ikur një arsyeshmëri që është bërë në 2007, që sipas ligjit kjo arsyeshmëri i ka vlerë vetëm 2-vjet-dhe këtë e ka bërë një komision i ministrisë së Mjedisit, këta nuk e kanë vërejtur për shkak të numrit të madh të lëndëve në gjithë Kosovën. Ne duhet ta fillojmë procedurën prej fillimit, pas shfuqizimit.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së ndonjë pyetje?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash po kalon për kuvend pika për shfuqizim të vendimit Nr.63/23.

14. Raporti 6 Mujor i punës së kryetarit;

Nënkryetari – Faleminderit kryesues! Të nderuar antarë të KPF-së. Ne e vendosëm në KPF në mënyrë që të procedohet për në kuvend raporti 6 mujor i kryetarit të komunës, t’i shmangemi pikës shtesë direkt në kuvend. Me datë 26 do të mbahet edhe dëgjimi i parë, ftoheni të jeni prezent.

Kryesuesi – Faleminderit nënkryetar! A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së ndonjë pyetje?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

15. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, P-01313-3, ZK- Rahovec.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues! Bëhet fjalë konkretisht për parcelën ku preket me projektin e Sheshit Qëndror. Në një seancë të kaluar kemi provuar me parcelizim të parcelës, kjo e drejtë garantohet me Hartë Zonale, e ne fatkeqësisht nuk e kemi ende hartën. Po provojmë ta ndjekim një rrugë tjetër ligjore, që është interesi i përgjithshëm duke qenë në dakordim të plotë me pronarët e parcelës. (Tasim Dula, Hysnije dhe Hajrulla Bahtjar Dula). Sipërfaqja e përgjithshme është 8 ari e 28m, ne kërkojmë nga ju që ta shpallim me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës me sipërfaqe prej 4 ari e 46m. Në të ardhmen do të kërkojmë përlqim për këmbimin e kësaj parcele me parcelë komunale.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së ndonjë pyetje rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet pika e 15-të.

16. Të ndryshme;

Kryesuesi – Nëse dikush prej anëtarëve të komitetit ka ndonjë pyetje apo propozim për diskutim? Nëse jo, atëherë këtu po e përmbylлим mbledhjen e gjashtë të rregullt të KPF-së. Mirëmbetshi, shihemi në seancë.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00

Procesmbajtësi;

Albion Krasniqi

